



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:069358
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607259

Në çështjen juridike të: AC-I-24-0179-A0001

Paditëse/Ankuese

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kundër:

Të paditurat:

- S R M nga Prishtinë.
- "W" SHPK
- "K" SHPK, Prizren
- B D nga Prishtina
- "L G" SHPK, me seli në Malishevë, që të gjithë të përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati V H, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-23-0075, të datës 1 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

2. Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-23-0075, i datës 1 shkurt 2024.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 3 janar 2024, paditësja/propozuesja kishte paraqitur një propozim për caktimin e masës së sigurimit me propozim që të aprovohet në tërësi si i bazuar propozimi i propozueses ashtu që kundër propozuesve t’iu ndalohet ndërmarrja e çfarëdo lloj veprimi juridik lidhur me njësinë kadastrale-parcelën nr. P-....., ZK Çagllavicë, vendi i quajtur “L V”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 39201 m² të tjetërsojnë, lejnë në hipotekë dhe peng, ndërtim si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërive deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje gjyqësore. Në propozim, propozuesja kishte propozuar se pronare e vetme legjitime e parcelës P-..... me sipërfaqe të përgjithshme prej 39201 m², ZK Ç është AKP-ja- N.SH “Radio Televizioni i Prishtinës” – RTP. Në lidhje me këtë parcelë e paditura nr. 1 S M kishte ushtruar kërkesë kreditore pranë Autoritetit të Likuidimit për njohjen e të drejtës së pronësisë në parcelën e lartcekur dhe kjo kërkesë ishte refuzuar si e pavlefshme përmes vendimit PRN150-2462. Në ndërkohë e paditura e lartcekur e kishte pretenduar pronësinë mbi parcelën në fjalë në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit me nr. C.nr.56/76 përmes të cilit ishte aprovuar kërkesëpadia e të njëjtës dhe është vërtetuar se është pronar i ngastrës numër ... sipas fletës së posedimit nr. ... ZK Ç, Prishtinë, në sipërfaqe prej 3.92.01ha në vendin e quajtur “I” në bazë të kontratës për ndërrimin e tokës. Parashtruesja e kërkesës në atë kohë kishte deklaruar se ka lidhur kontratë me ë paditurën për ndërrimin e tokave. Në lidhje me këtë Aktgjykim AL kishte dyshime të bazuara për vërtetësinë e përmbajtjes së tij për marrëveshjen ndërmjet N.SH-së dhe S M mbi bazën e të cilës është bërë shkëmbimi i pronave. Në aktgjykim fare nuk ishte cekur numri ref. i Kontratës, data apo ndonjë element tjetër përshkrues i kësaj kontrate. AKP-ja duke mos dashur të shërbehet me paragjykimet ndaj këtij Aktgjykimi, me datë 2 mars 2023 e kishte dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren kërkesën për sigurimin e Aktgjykimit me nr. C.nr.56/76 të datës 28 prill 1976 përmes të cilit parcela kadastrale nr. ... kishte kaluar në emër të S R M. Me datë 9 mars 2023, AKP-ja kishte pranuar përgjigje nga Gjykata Themelore në Prizren ku ishte njoftuar se lënda me numrin e lartcekur nuk gjendet në këtë gjykatë dhe as nuk figuron në regjistrin e lëndëve që janë dërguar në Arkivin Qendror të Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në ndërkohë AKP kishte pranuar nga Departamenti i Krimeve Ekonomike i autorizuar nga Prokuroria

Themelore në Prishtinë për të hetuar rastin në fjalë se janë paraqitur rrethana të reja që vërtetojnë të gjitha dyshimet e shprehura nga AKP e të cilat të dhëna janë në mospërputhje me Aktgjykimin e lartcekur. Situata faktike në këtë rast është se kundërshtarja e parë e sigurimit në mënyrë tërësisht të paligjshme ka poseduar me parcelën dhe ndaj të njëjtës është sjellë sikur të jetë pronare dhe mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara ka disponuar me parcelën e lartcekur duke e shitur atë në pjesë ideale tek tre persona të tjerë. Duke pasur parasysh vlerësimi meritore të provave dhe bazën juridike për bartjen e posedimit si dhe mënyrën e procedimit të tyre nga ana e Zyrës Kadastrale të Komunës së Prishtinës, AKP konsideron se e njëjta nuk ka pasur të drejtë që të lejoj ose të marrë Aktvendim sipas të cilit ka bërë bartjen e posedimit në mënyrë jo ligjore. Për tu caktuar masa e sigurimit në bazë të kërkesës së propozuesit duhet të përmbushen dy elemente në mënyrë kumulative dhe në rastin konkret propozuesja konsideron se e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës subjektive duke marrë parasysh që gjitha faktet që janë paraqitur si dhe konsideron se është përmbushur edhe kushti i dytë që ka të bëjë me faktin se po të mos caktohet masa e sigurimit, propozuesja do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme.

Propozimit i kishte bashkëngjitur këto prova: një Aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Prizren me nr. 56/76 të datës 28 prill 1976, formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, kopjen e letërnjoftimit të S M, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN150-2462 të datës 8 shkurt 2023, një kërkesë për sigurimin e Aktgjykimit nga AKP për Gjykatën Themelore në Prizren e datës 2 mars 2023, një përgjigje e Gjykatës Themelore në Prizren e datës 9 mars 2023, një listë të lëndëve civile, një kopertinë të fotokopjuar me titullin Gjykata e Qarkut në Prizren, një kontratë për shitje-blerjen e pjesës ideale të patundshmërisë nr. LRP:7320/2022 me nr. REF:2419/2022 e datës 21 qershor 2022, një kontratë për shitje-blerjen e pjesës ideale të patundshmërisë nr. LRP:7322/2022 me nr. REF:2421/2022 e datës 21 qershor 2022, një kontratë për shitje-blerjen e pjesës ideale të patundshmërisë nr. LRP:...me nr. REF:... e datës .. qershor.., një kontratë për ndarjen fizike (kadastrale) të bashkëpronësisë me nr. LRP:..., REF.nr.... e datës .. dhjetor ... si dhe padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit nga AKP e datës 17 mars 2023.

Me datë 11 janar 2024, të paditurat përmes përfaqësuesit të tyre kishin paraqitur një kundërshtim të propozimit për caktimin e masës së sigurimit. Në kundërshtim theksohej se të paditurat e kundërshtojnë në tërësi këtë propozim të përsëritur të propozueses së sigurimit, duke theksuar se

propozuesja nuk e ka cekur aktvendimin e kësaj gjykate të datës 29 maj 2023 për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit dhe i cili Aktvendim është vërtetuar me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-23-0368 si i bazuar, duke vërtetuar faktin se propozuesja nuk e kishte bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së saj subjektive si dhe nuk është argumentuar rreziku i kanosur për shkaktimin e ndonjë dëmi ndaj saj. Tutje, të paditurat kishin theksuar serish çështjen e tentimit të vënies në lajthitje të gjykatës duke ia bashkëngjitur propozimit të saj të njëjtat prova që përfshijnë certifikatën e pronësisë, Aktgjykimin në bazë të pohimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C.nr.56/76, kërkesën drejtuar Gjykatës Themelore në Prizren dhe përgjigjen e kësaj gjykate për sigurimin e dokumentit si dhe kontratat e shitblerjes të cilat gjykatës ia ka propozuar që të anulohen, nën pretendimin se e paditura të njëjtat i ka lidhur pa qenë asnjëherë e regjistruar si pronare e ngastrës lëndore si dhe duke ia bashkëngjitur edhe provat që i ka dorëzuar edhe më herët, të cilat të paditurat i konsiderojnë si të pabazuara, duke theksuar se kundërshtarja e sigurimit S M nga Prishtina nuk ka qenë e regjistruar si titullare e ngastrës kadastrale si dhe në rastin e paditëses-propozueses së sigurimit nuk janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë. Andaj, kishte propozuar që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: një përgjigje lidhur me kërkesën e Drejtorisë Kadastrale të Komunës së Prishtinës të datës 28 tetor 2021 dhe një listë e lëndëve civile.

Me datë 24 janar 2024, propozuesja e sigurimit kishte paraqitur kundërpërgjigjen e saj në përgjigje të së paditurave në të cilën i kishte kundërshtuar pretendimet e të paditurave duke theksuar se ky propozim është përsëritur për arsye se nga Departamenti i Krimeve Ekonomike janë njoftuar se janë paraqitur rrethana të reja e konkretisht kanë pranuar foto të regjistrit të Gjykatës së Qarkut në Prizren ku në numrin rendor 56/76 figurojnë krejtësisht palë tjera dhe jo S M. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet parashtesa e datës 11 janar 2024 si e pabazuar apo e papranueshme dhe të aprovohet në tërësi si i bazuar propozimi i propozueses ashtu që kundër propozuesve të iu ndalohej ndërmarrja e çfarëdo veprimi juridik lidhur me njësinë kadastrale-parcelën nr. P-..... ZK,Çnë vendin e quajtur “L V” në sipërfaqe prej 39201 m2 që ta tjetërsojnë, lejnë në hipotekë dhe peng, ndërtim si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat kadastral të paluajtshmërive deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje gjyqësore.

Me datë 1 shkurt 2024, DHPGJS kishte mbajtur seancën dëgjimore lidhu me propozimin për caktimin e masës së sigurimit në të cilën kishin prezantuar AKP dhe përfaqësuesi i autorizuar i

të paditurave, avokati V H. Në seancën dëgjimore, paditësja kishte deklaruar se i qëndron në tërësi qëndrimeve të pretendimeve të shprehura në propozimin për caktimin e masës së sigurimit të dorëzuar në gjykatë për herë të dytë me datë 28 dhjetor 2023, për faktin se me datë 27 dhjetor 2023 kishte pranuar nga Departamenti i Krimeve Ekonomike prova të reja në lidhje me regjistrin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, konkretisht disa fotografi të regjistrit të kësaj gjykate ku në numrin rendor 56/76 figurojnë krejtësisht palë tjera dhe jo e paditura. E këto të dhëna identifikojnë palë të tjera dhe këto të dhëna janë në mospërputhje me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren më numër C.nr.56/76 si dhe kishte kërkuar nga gjykata që të marrë aktvendim ashtu që të aprovoj në tërësi si të bazuar propozimin e AKP-së. Përfaqësuesi i të paditurave në seancën dëgjimore kishte theksuar se e kundërshton në tërësi propozimin e propozueses për caktimin e masës së sigurimit për faktin se i njëjti është i pabazuar në asnjë provë materiale e që edhe vet prova e prezantuar nga propozuesja si provë e re fare nuk e vërteton pretendimin e të njëjtës në drejtim të asaj se me numrin rendor C.nr.56/76 të Gjykatës së Qarkut në Prizren paraqiten tërësisht palë tjera dhe jo këto palë ndërgjyqëse. Gjithashtu shton se fotografia e siguruar si provë e re e cila është pjesë e po këtij libri vërteton edhe me shumë se 13 çështje tjera gjyqësore të cilat nuk përputhen me të dhënat e paraqitura në libër rendor të Gjykatës së Qarkut në Prizren. Andaj të paditura kishin konsideruar se “prova e re” e prezantuar nuk është asnjë provë me relevancë dhe në asnjë mënyrë nuk e mbështetë propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurimit dhe i propozon gjykatës ta refuzoj si të pabazuar. Kësaj çështje i ishte bashkëngjitur si provë një Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër A.nr.839/2023 i datës 24 nëntor 2023.

Me datë 1 shkurt 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-23-0075 kishte refuzuar si të pabazuar propozimin e propozueses për caktimin e masës së sigurimit. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi, Kolegji i shkallës së parë kishte arsyetuar se AKP edhe përkundër parashtrimit të provave gjegjëse nuk e kishte bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së saj subjektive që të pranohet propozimi i saj për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për ngastrën kadastrale në fjalë. Pa paragjykuar deri në vendosjen e kësaj gjykate lidhur me pjesën kryesore të kërkesëpadisë së paditëses/propozueses bazuar në provat dhe dokumentet e paraqitura nuk e kishte bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së saj që të pranohet propozimi sepse e paditura e parë S M e kishte poseduar aktgjykimin e plotfuqishëm në bazë të pohimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.56/76 të datës 28 maj 1976, si vendim gjyqësor i cili kishte shërbyer si bazë ligjore për Zyrën Komunale Kadastrale në Prishtinë për të kryer bartjen e pronës

në fjalë fillimisht në emrin e të paditurës së parë e më vonë në bazë të kontratave përkatëse të saj edhe në emër të së paditurve të tjerë/kundërshtarëve të sigurimit. Në fund gjykata kishte vlerësuar pra se propozimi i paditëses/propozueses së sigurimit nuk i plotëson kriteret ligjore të parapara me nenin 61 paragrafi 1 të Ligjit të Dhomës së Posacme e në vështrim të shkaktimit të dëmit të menjëhershëm e me këtë edhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit e kishte refuzuar si të pabazuar.

Me datë 8 mars 2024, AKP-ja kishte paraqitur një ankesë kundër Aktvendimit C-III-23-0075 të datës 1 shkurt 2024, për shkak të mos zbatimit të drejtë të dispozitave procedurale, mos vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit që të shfuqizoj Aktvendimin e ankimuar me të cilin është refuzuar kërkesa e AKP-së për caktimin e masës së sigurimit për herë të dytë në njësinë kadastrale-parcelën P-....., ZK Ç, vendin e quajtur “L V” në sipërfaqe të përgjithshme 39201 m² si dhe të aprovoj ankesën e AKP-së si të bazuar dhe caktimin e masës së sigurimit ose të kthej çështjen në rivendosje në shkallë të parë. Në ankesë theksohet se Autoriteti i Likuidimit shpreh mospajtim të plotë me qëndrimin e gjykatës se AKP-ja nuk e kishte bërë të besueshme ekzistencën e të drejtës subjektive për shkak se kishte konsideruar se sidomos pas paraqitjes së fakteve të reja është bërë evidente ekzistenca e të drejtës subjektive. Është bërë evidente se në regjistrin e Gjykatës së Qarkut në Prizren nuk përputhen të dhënat tek nr. rendor 56/76 ngase aty figurojnë palë krejtësisht tjera dhe jo palët sikur në Aktgjykimin P.nr.56/76. Në lidhje me këtë Aktgjykim, AL ka dyshimet e bazuara për vërtetësinë e përmbajtjes së tij për “marrëveshjen” mes N.SH “Radio Televizioni i Prishtinës” – RTP dhe S R M mbi bazën e së cilës është bërë shkëmbimi i provave. Në aktgjykimin fare nuk është cekur numri ref. i kontratës apo ndonjë element tjetër përshkruar i kësaj kontratë. Kjo kontratë për shkëmbim të pronave mbi bazën e së cilës është marrë edhe Aktgjykimin nuk ekziston as në shkresë të lëndës. Propozuesja konsideron se e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës subjektive duke marrë parasysh të gjitha faktet e elaboruara në kërkesëpadi. Gjithashtu, konsideron se në mënyrë kumulative është përmbushur edhe kushti i dytë që ka të bëjë me faktin se po të mos caktohet masa e sigurisë propozuesja do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë. Ankesës ia kishte bashkëngjitur Aktvendimin e ankimuar.

Me datë 22 mars 2024, të paditurat kishin paraqitur përgjigje në ankesën e lartcekur, në të cilën kishin theksuar se propozuesja nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim të vetëm në konstatimin e DHPGJS-së se vet propozuesja nuk kishte shprehur asnjëherë asnjë kundërshtim në drejtim të 5 provave të prezantuara na palët ndërgjyqëse mbi verifikimin e vërtetësisë dhe ruajtjes së titullit juridik në organin kompetent sikurse as që ka komentuar fare Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.839/2023 të datës 24 nëntor 2023 me të cilin padia e AKP-së ishte hedhur poshtë si e pabazuar dhe tashmë nuk ka asnjë bazë të vetme ligjore për të kontestuar cilindo akt ligjor e për të cilën çështje vet përfaqësuesit e AKP-së qëllimshëm nuk e kishin njoftuar gjykatën. Andaj, të paditurat i kishin propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e propozueses dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i bazuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kriteret se kur duhet të lëshohet masa e përkohshme përcaktohen në nenin 55.1 të Shtojcës së LDHP-së: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtrim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në pretendimet ankimore dhe në provat nga shkresat e lëndës gjënë se ankesa është e pabazuar, ndërsa Aktvendimi i ankimor është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm, vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me kompensim monetar. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra më lart mungon kërkesa nuk miratohet.

Në dosjen e shkallës së parë gjendet, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren me nr. 56/76 të datës 28 prill 1976 me të cilin prona në fjalë kishte kaluar emër të S R M.

Andaj në çështjen konkrete juridike, Kolegji i shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se paditësi në këtë fazë nuk ka arritur të dëshmoj probabilitet të lartë të së drejtës së pretenduar si dhe rrezikun e humbjes apo dëmtimit që mund të paraqitet në këtë pronë. Barra e të provuarit gjithsesi i takon atij.

Dyshimet e saj të ngritura lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren me nr. 56/76 të datës 28 prill 1976 si dhe fillimi i hetimit lidhur me transferimin e patundshmërisë kontestuese nuk janë argumente ligjore të cilat mbështesin caktimin e masës së sigurisë. Gjithsesi këto mbesin të trajtohen kur të vendoset për meritat e padisë.

Andaj duke u bazuar në këto prova të lëndës, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se kërkesa për caktimin e masës së sigurisë me të drejtë është refuzuar si e pabazuar, pasi që kërkesa nuk i plotëson kushtet nga neni 61 i LDHP-së.

Kolegji i Apelit konstaton se në këtë fazë të procedurës pohimet e paditësit nuk janë arsye të mjaftueshme të caktohet masa e sigurisë.

Prandaj nga këto arsye Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të shkallës së parë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Ky Aktvendim nuk predikon në asnjë formë zgjidhjen e meritave të padisë.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së u vendos si në dispozitiv

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 20 mars 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____